



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 59

2002

Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 3473 datë 19.9.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	1649
Vendim i KM nr. 467, datë 3.10.2002	Për miratimin e Kontratës Koncesionare të formës "Rot" ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë, nga njëra anë, dhe shoqërisë italiane "Essegei", s.r.l., nga ana tjetër, për hidrocentralet vendore.....	1650
Vendim i KM nr. 469, datë 3.10.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 371 datë 4.8.1999 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe kompetencat në fushën e standardizimit, certifikimit dhe akreditimit".....	1658
Vendim i KM nr. 470, datë 3.10.2002	Për kushtet e dhënies së autorizimit zyrtar dhe rregullat e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.....	1658

Vendim i KKRT nr. 113, datë 30.9.2002	Për dhënie licence për radio vendore private “Alsat 1”	1662
Vendim i KKRT nr. 114, datë 30.9.2002	Për dhënie licence për radio vendore private “Fantasy”	1663
Vendim i KKRT nr. 116, datë 30.9.2002	Për dhënie licence për radio vendore private “Rock”	1663
	Shpallje kërkesë për shpronësim për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor Bogovë-Çorovodë”	1664
	Shpallje kërkesë për shpronësim për ndërtimin e objektit “Segmenti rrugor Tapizë-Fushë-Krujë”	1668
	<i>Kërkesë</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Fatmir Xhemal Xhelili.....	1668

DEKRET
Nr. 3473, datë 19.9.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Petrit Rrapo Musaraj
2. Mirvjene Esat Musaraj (Xhaferri)
3. Erjola Petrit Musaraj
4. Klodiana Petrit Musaraj
5. Ilir Nevruz Metushi
6. Afërdita Meleq Metushi (Fortuna)
7. Vasilika Ndreko Zherdi (Feshti)
8. Marina Llambi Zherdi
9. Ignis Llambi Zherdi
10. Landa Kolë Voltmer (Ndoci)
11. Elona Shyqyri Schulz (Toska)
12. Fatbardha Prelë Lulashi
13. Lorena Lulashi
14. Genc Muhamer Kokalari
15. Oreada Burhan Çelo
16. Monika Josif Kole
17. Clyde Genc Kole
18. Tatjana Shaban Sula
19. Artur Ali Tahiri
20. Joel Artur Tahiri
21. Kadri Ibrahim Dibra
22. Alen Kadri Dibra
23. Marjana Dhimitër Dibra (Pano)
24. Luan Nuri Arapi
25. Toni Winfried Luan Arapi
26. Lumturi Bardhyl Arapi (Qatipi)
27. Lejdi Luan Arapi
28. Nazmi Zia Lleshi
29. Rezhana Nazmi Lleshi
30. Haris Nazmi Lleshi
31. Majlinda Sefulla Lleshi (Shehu)
32. Albana Muntaz Beicher (Kokalari)
33. Suzana Dule Riese (Meminaj)
34. Gjergji Bashkim Kozeli
35. Artan Napolon Glina

36. Kevin Artan Glina
37. Manjola Zijaudin Glina (Grapshi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 467, datë 3.10.2002

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE TË FORMËS "ROT" NDËRMJET
MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS DHE MINISTRISË SË
EKONOMISË, NGA NJËRA ANË, DHE SHOQËRISË ITALIANE "ESSEGEI", S.R.L., NGA
ANA TJETËR, PËR HIDROCENTRALET VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 9 pika 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë" dhe të nenit 2 të ligjit nr.8527, datë 23.9.1999 "Për privatizimin e hidrocentraleve vendore" me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Kontratës Koncesionare të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë, nga njëra anë, dhe shoqërisë italiane "ESSEGEI" s.r.l., nga ana tjetër, për hidrocentralet vendore, sipas listës së aneksit nr.1, që i bashkëlidhet Kontratës.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e kësaj Kontrate.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
KONCESIONI NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS DHE
MINISTRISË SË EKONOMISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR
LIGJËRISHT NGA...DHE KOMPANISË ITALIANE "ESSEGEI" S.R.L., PËRFAQËSUAR NGA
PRESIDENTI VINCENZO MARCO JORIO,

Më poshtë referuar si "Koncesionari".

Meqenëse, Qeveria Shqiptare:

- konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një mjet të rëndësishëm të politikës energjetike dhe konfirmon një interes të lartë në privatizimin e hidrocentraleve vendore për të vlerësuar asetet publike (objektet dhe makineritë) që po degradohen;

- vlerëson formulën e koncesionit ROT, sepse kjo bën të mundur rehabilitimin e hidrocentraleve vendore pa prekur Buxhetin e Shtetit;
- mirëpret kompanitë private në rehabilitimin, ruajtjen e aseteve dhe të kapaciteteve prodhuese të hidrocentraleve vendore, si dhe fuqizimin e disave prej tyre;
- autorizon KESH-in si të vetmin marrës aktual të energjisë elektrike, të përcaktojë dhe të firmosë një kontratë efektive blerjeje me Koncesionarin;
- autorizon, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 27.5.2001, Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrinë e Ekonomisë të negociojnë dhe të firmosin Kontratën e Koncesionit.

Ndërsa, Koncesionari:

- është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;
- ka ndërmarrë studimin e pre-fizibilitetit "Identifikimi i aftësisë së investimeve në hidrocentralet e vogla në Shqipëri" për një numër të dhënë hidrocentralesh dhe ka kryer vëzhgime dhe inspektime në këto hidrocentrale;
- ka kryer vlerësime të reja, nëpërmjet specialistëve me eksperiencë, që gjykojnë hidrocentralet me mjaft interes, pavarësisht nga gjendja e tyre aktuale;
- beson plotësisht që Qeveria Shqiptare do të mbështesë përpjekjen e Koncesionarit në gjetjen e zgjidhjeve efektive; për problemet e evidentuara në studimin e pre-fizibilitetit (kompleksiteti, rreziqet, politikën aktuale të çmimeve);
- konsideron që ndërmarrja mund të bëhet e suksesshme në kushte të caktuara ekonomike dhe operuese;
- është e aftë të rehabilitojë dhe menaxhojë hidrocentralet e vogla lokale (HPP) në listën e miratuar, me përjashtim të listës që jepet në aneksin nr. 2 të kësaj Kontrate;

Ndërsa, Palët:

- marrin parasysh pëlqimin të shprehur formalisht nga KESH-i për sa ka të bëjë me blerjen e elektricitetit nga Koncesionari, sipas kushteve të pranuar nga Palët (KESH dhe Koncesionari);
 - bien dakord që të bashkëpunojnë për realizimin e plotë të Projektit.
- Palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara:

Kontrata e Koncesionit: Kjo Marrëveshje dhe anekset e saj.

Kontrata: Të gjitha kontratat që mund të lidhen në të ardhmen nga Koncesionari.

Ndryshimi i ligjit: Do të thotë çdo akt që ka karakter rregullator ose ligjor të miratuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë.

Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'i kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e plotë të Projektit, si dhe për stafin e vet, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Koncesionari: "ESSEGEI" s.r.l.

Hidrocentralet: Përcaktohen me vendimin nr. 355, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dhënies në koncesion të hidrocentraleve vendore", me përjashtim të hidrocentraleve të përshkruara në aneksin nr.2.

Projekti: Rehabilitimi i hidrocentraleve të vogla vendore në të gjithë Shqipërinë (0.2-1.2 MWA fuqi), sipas listës së mëposhtme, dhe në përputhje me formën ROT (Rehabilitim-Shfrytëzim-Transferim).

Fillimi i Projektit: Janë një seri veprimtarish komplekse (verifikimi i gjendjes aktuale, plani i ristrukturimit, programimi i marrjes në dorëzim të hidrocentraleve) që do të kryen nga Koncesionari dhe nga entitete të autorizuar për të bërë të mundur fillimin e implementimit të Projektit, me pjesëmarrjen dhe asistencën aktive të ASE-së.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Objekt i kësaj Kontrate është dhënia me koncesion e hidrocentraleve (si përcaktohen në nenin 1), në përputhje me formën ROT:

- (a) rikonstruksioni rinovimi-rehabilitimi, rifuqizimi me një nivel të pranueshëm sukcesi;
- (b) shfrytëzimi optimal tekniko-ekonomik i tyre;
- (c) kthimi i aseteve të rehabilituar shtetit, në parametrat teknike dhe sipas investimeve të parashikuara.

Neni 3

Kohëzgjatja e Koncesionit

Kontrata e Koncesionit për H/C e sipërpërmendur do të ketë një kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës.

Neni 4

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektivat e Marrëveshjes lidhur me termat dhe kushtet e saj.

Në detaje, Koncesionari angazhohet që:

- brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të formojë Shoqërinë Koncesionare dhe do të bëjë regjistrimet e nevojshme për të lejuar shoqërinë të zhvillojë veprimtarinë e saj në Shqipëri, si dhe do t'u nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare;
- të implementojë programin e fillimit të punës për pjesën që është nën përgjegjësinë e tij, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit aktiv me OSHA-në;
- të rinovojë H/C sipas përcaktimit të nenit 1, nëpërmjet projektit të financimit për një shumë deri në 10 (dhjetë) milion US \$, por jo më pak se 8 (tetë) milion USA \$;
- të marrë masa me qëllim që çdo punim i besuar në Projekt të jetë i përmbushur në përputhje me afatet dhe me cilësinë e parashikuar në këtë Kontratë;
- të ruajë e të administrojë objektin e Kontratës dhe të shesë energjinë e prodhuar, gjatë gjithë periudhës së koncesionit, në përputhje me specifikimet e kësaj Kontrate;
- në veprimtarinë e tij, të respektojë legjislacionin shqiptar në fuqi, në veçanti për fushën ku vepron, të respektojë ligjet për energjinë elektrike dhe për sektorin elektroenergetik;
- të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- të përcaktojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm gjatë kohëzgjatjes së koncesionit, edhe ndaj Palëve të treta;
- në përfundim të koncesionit (30 vjet), Koncesionari është i detyruar t'i dorëzojë OSHA-së të gjitha H/C në gjendje pune (përveç veprimit të forcave madhore) dhe me një rezervë të pjesëve të këmbimit për një vit.

Koncesionari nuk përgjigjet për të gjitha detyrimet që objektet e marra në koncesion kanë ndaj shtetit dhe të tretëve deri në hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate.

Neni 5 Detyrimet e OSHA-së

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) angazhohet të garantojë dhe të marrë përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Të bashkëpunojë në mënyrë aktive për inventarizimin e objekteve, duke bërë të mundur vërtetimin e gjendjes aktuale në të cilat ndodhen objektet e koncesionit, që Koncesionari angazhohet të përpilojë brenda programit të fillimit të punimeve.

- Të ndihmojë Koncesionarin në përgatitjen e një seri rregullash e orientimesh për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e Projektit, si përcaktohet në nenin: asistencë në aplikim; mbështetje e marrëveshjeve me institucionet e përshtatshme (të punës, të shitjes së energjisë, të ujërave); mbështetje në aplikimet (garancitë dhe taksat).

- Të asistojë Koncesionarin në finalizimin e një marrëveshjeje afatgjatë për shitjen e energjisë elektrike me KESH-in (Korporata Elektro-Energjetike Shqiptare). Për këtë qëllim, sipas çmimit të shitjes së energjisë elektrike të aprovuar nga ERE-ja (Enti Rregullues i Energjisë), KESH-i sh.a. është i autorizuar të firmosë me Koncesionarin një marrëveshje afatgjatë për shitjen e energjisë elektrike për energjinë e prodhuar.

- Të asistojë Koncesionarin pranë KESH-it ose institucioneve të ngarkuara në nxjerrjen e të gjitha autorizimeve të nevojshme, lejet e punimeve, lejet e ndërtimeve dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari për transmetimin në linjat e tensionit të mesëm të energjisë së prodhuar. Kërkesat do të jenë të përpiluara në formën që e kërkon ligji i koncesionit për të gjithë kohëzgjatjen e tij.

- Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi, që lidhet me pretendimet e personave fizikë dhe juridikë të ndryshëm për pronësinë mbi objektet e dhëna në koncesion.

- Të ofrojë asistencën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të objekteve të koncesionit, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

- Të asistojë Koncesionarin pranë çdo organi e autoriteti shqiptar për realizimin e Projektit të tij dhe t'i garantojë Koncesionarit ekskluzivitetin për realizimin e Projektit mbi objektet e dhëna në koncesion, gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

- Të asistojë Koncesionarin në zgjidhjen e problemit të shpërdorimit të rezervave ujore pranë Komitetit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

- Të ndihmojë Koncesionarin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me KESH-in dhe institucione të tjera, administratat lokale, bashkitë e komunat, ndërmarrjet e ujërave etj.

Neni 6 Mbështetja për Projektin

OSHA-ja do të paraqesë në Këshillin e Ministrave projektligje për përjashtimin e Koncesionarit, për kohën e investimeve, nga detyrimet e taksave, TVSH-ja për makineritë, mjete dhe materialet e tjera, të cilat do të përdoren për investime sipas specifikimeve në Projekt dhe në marrëveshje me OSHA-në.

Neni 7 Vlerësimi i investimeve

Nga të dhënat efektive, investimi për rehabilitimin e hidrocentraleve do të jetë në vlerën 8 milionë USD. Vlerësimi i mësipërm mund të rishikohet:

- sipas rezultateve të vlerësimeve (vërtetimi i gjendjes së centraleve të të dhënave dhe informacionit që mund të japë KESH-i);

- në çdo kohë gjatë zbatimit të detajuar të Projektit.

Neni 8

Puna, fuqia punëtore dhe riorganizimi i punës

Analiza e hollësishme e punës, punësimi internal dhe programet e trajnimit do të hartohen në marrëveshje me autoritetet kompetente dhe do të implementohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9

Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e mëposhtëm:

- Koncesionari garanton aktivizimin e programit të fillimit të punës brenda një afati prej 60 ditësh, duke filluar nga data e hyjres në fuqi të Kontratës së Koncesionit.
- OSHA-ja ka të drejtë të prishë Kontratën në mënyrë të njëanshme, nëse Koncesionari, brenda 60 ditësh nga data e hyjres në fuqi të kësaj Kontrate, nuk realizon detyrimet kontraktuale të mësipërme.
- OSHA-ja ka të drejtë të prishë kontratën në mënyrë të njëanshme nëse Koncesionari nuk kryen Programin e Investimeve. Në këtë rast, investimet e bëra nga Koncesionari deri në momentin e heqjes së Koncesionit do të mbeten pronë e OSHA-së.
- Koncesionari garanton të përfundojnë Projektin brenda një afati 6 vjetësh, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të hidrocentralit të parë.
- Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis dy Palëve.

Neni 10

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

OSHA-ja dhe Koncesionari mund të kërkojnë të anulojnë këtë Marrëveshje nëse Pala tjetër nuk plotëson detyrimet për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas legjislacionit shqiptar.

Në rast të konfirmimit të çështjes për pretendimet e kësaj Marrëveshjeje, Pala e dëmtuar do të njoftojë menjëherë për këto pretendime Palën tjetër, e cila, brenda 30 ditëve, duhet të japë një përgjigje argumentuese. Në bazë të kësaj përgjigjeje, Pala e dëmtuar do të gjykojë për të filluar ose jo procedurën për zgjidhjen e Marrëveshjes.

Neni 11

Marrëveshjet e aplikuara dhe kontratat

Duke iu referuar neneve 1,4,5,8 dhe 22 të kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të zbatojë Projektin, duke përgatitur, diskutuar, përbushur dhe firmosur, me pjesëmarrjen aktive të OSHA-së, të gjitha aplikimet, marrëveshjet dhe kontratat.

Koncesionari, për të përbushur detyrimet e Kontratës së Koncesionit, është gjithashtu i autorizuar të nënshkruajë marrëveshje nënkontraktore me Palë të tjera për rehabilitimin e hidrocentraleve sipas Projektit.

Koncesionari do të ketë përgjegjësi ndaj OSHA-së për të gjitha punimet për rehabilitimin e hidrocentraleve.

OSHA-ja nuk ka përgjegjësi kundrejt Palëve të treta, punëtorëve apo sipërmarrësve që kanë lidhje me Koncesionarin, përveç detyrimeve që OSHA-ja ka marrë përsipër në këtë Marrëveshje.

Neni 12

Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë me shpenzimet e veta objektet e kësaj Kontrate që lidhen me Projektin për të gjithë kohëzgjatjen e Koncesionit.

Me kërkesën e OSHA-së, Koncesionari do t'i japë asaj të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me sigurimet e objekteve.

Në rast se një objekt i siguruar do të dëmtohet dhe është i mbuluar nga sigurimet, të ardhurat nga siguracioni do të përdoren nga Koncesionari për riparimin e objektit.

Neni 13

Riparimi dhe mirëmbajtja

Koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha llojet e riparimeve dhe mirëmbajtjes në objektet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 14

Kontrolli i përgjithshëm

OSHA-ja mund të ushtrojë një kontroll të përgjithshëm gjatë operacioneve të rehabilitimit dhe të përgatitjes për punë, nëpërmjet të autorizuarve në marrëveshje të përbashkët midis Koncesionarit dhe OSHA-së, me qëllim që të verifikojë nëse punimet janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të Projektit.

Koncesionari duhet të japë të gjitha sqarimet teknike të nevojshme.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, kompania do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohen në legjislacionin shqiptar në fuqi.

OSHA-ja garanton se të gjitha ligjet dhe rregullat, që eventualisht do të dalin pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, nuk do të ndryshojnë detyrimet kontraktuale të Palëve.

Neni 16

Transferimi i fitimit

Në çdo rast, Koncesionari ka të drejta për transferimin e lirë të fitimeve.

Ata gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për investimet e huaja në Shqipëri.

Neni 17

Forca madhore dhe të paparashikura

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet ngjarjet e jashtëzakonshme politike, lufta (dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit) dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Kontratës, që kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

Palët nuk do të jenë përgjegjëse nëse nuk arrijnë detyrimet e tyre të kësaj Kontrate si rezultat i ngjarjes së forcës madhore.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Kontrate do të priset ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Nëse gjatë implementimit të Kontratës do të ketë veprim të forcave madhore atëherë Palët mund të mos zbatojnë detyrimet e tyre, në këtë rast nuk do të kërkohet kompensim reciprok nga Palët.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve do të konfirmohet nga Palët në një procesverbal të ngjarjes.

Si rrjedhim i ngjarjeve të shkaktuara nga një forcë madhore, kohëzgjatja e koncesionit do të zgjatet për një periudhë kohe të mëtejshme e të nevojshme, periudhë që caktohet me marrëveshjen midis dy Palëve.

Neni 18

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi në firmosjen e saj nga Palët dhe mbasi të jetë miratuar me vendim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike”.

Neni 19

Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjithë dokumentacionin, është bërë në gjuhën shqipe dhe angleze. Për ndonjë problem të ngritur me interpretimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Kjo Marrëveshje është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale, 5 (pesë) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet midis Palëve, që kanë lidhje me implementimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të anulojnë detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshjeje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje, si shkeljet, anulimin ose pavlefshmërinë e saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Arbitrimit, aktualisht në fuqi.

Gjykata e Arbitrimit do të përbëhet nga tre anëtarë. Secila Palë do të emërojë një arbitër dhe anëtari i tretë, i cili do të jetë kryetari, do të zgjidhet nga arbitrat.

Gjykata e Arbitrimit do të vendosë në mënyrë të paanshme për të dyja Palët brenda 90 ditëve të akuzimit.

Selia e arbitrave do të jetë në Londër dhe gjuha e përdorur do të jetë anglisht.

Neni 21

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizojnë Palët sipas një vendimi të Gjykatës së mësipërme të Arbitrimit.

Neni 22

Marrja në dorëzim e H/C

Marrja në dorëzim e H/C do të aktivizohet, në kuadrin e programit të fillimit të punimeve, në përputhje me grafikun e përgatitur me kujdes me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë dhe me KESH-in.

Neni 23

Bashkëpunimi midis OSHA-së dhe Koncesionarit

Organi shtetëror i autorizuar dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë implementimin e Projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër te personat e mëposhtëm, me postë, telegram ose fax në adresat e mëposhtme:

Për OSHA-në

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës
Sheshi Skënderbej, nr.2
Tiranë-Shqipëri
Për dijëni:
Fax: + +355 4 234 052

Për Koncesionarin

“ESSEGEI” S.r.l.
Via Adda 21,
00198 Roma, Italia

President
Vincenzo Marco Jorio

Ministria e Ekonomisë
Bulevardi “Zhan d’Ark”, nr.2
Tiranë-Shqipëri

ANEKS NR. 1

HIDROCENTRALET VENDORE – REHABILITIMI

Nr.	Emri i HEC	Vendndodhja (Rrethi)	Fuqia kW	Viti i ndërtimit	Investimi i rehabilit. (Elektromek. (USD)	Invest. Punim.Civile (USD)	Invest Logjistik (USD)	Investimi Total (USD)	Periudha e Investimit nga deri	Maxim Prodh Vjetor 000/kWh
1	Arras	Dibër	1200	1980	734,976	124,000	55,000	913,976	2002-2003	6,500
2	Funares	Librazhd	1000	1973	659,000	179,000	55,000	893,000	2002-2003	5,000
3	Dukagjin	Shkodër	640	1973	473,000	400,000	55,000	928,000	2007-2008	4,000
4	Nikolicë	Korçë	500	1975	338,000	80,000	50,000	468,000	2006-2007	1,320
5	Bulqizë	Bulqizë	400	1974	266,000	70,000	45,000	381,000	2006-2007	1,600
6	Lure	Dibër	400	1980	245,000	104,000	40,000	389,000	2002-2003	1,000
7	Orgjost	Kukës	400	1970	308,352	70,000	35,000	413,352	2007-2008	1,700
8	Lekbibaj	Tropojë	400	1979	308,352	70,000	35,000	413,352	2007-2008	2,700
9	Velçan	Korçë	320	1980	206,000	70,000	35,000	311,000	2006-2007	1,400
10	Zerqan	Bulqizë	250	1976	170,000	45,000	30,000	245,000	2006-2007	1,400
11	Borsh	Sarandë	250	1970	172,000	45,000	30,000	247,000	2004-2005	750
12	Leshnicë	Sarandë	250	1973	172,000	45,000	30,000	247,000	2004-2005	750
13	Shoshaj	Tropojë	230	1973	183,000	15,000	30,000	228,000	2003-2004	1,000
14	Ujanik	Skrapar	220	1975	144,000	40,000	25,000	209,000	2004-2005	700
15	Kerpicë	Gramsh	200	1075	158,000	40,000	25,000	223,000	2003-2004	950
16	Barmash	Kolonjë	200	1070	152,000	40,000	25,000	217,000	2004-2005	670
17	Voskopojë	Korçë	200	1972	159,000	40,000	25,000	224,000	2005-2006	210
18	Lunik	Librazhd	200	1977	150,000	70,000	25,000	245,000	2002-2003	900
19	Piqeras	Sarandë	200	1971	159,000	40,000	25,000	224,000	2004-2005	860
20	Homesh	Bulqizë	150	1974	152,000	43,000	25,000	220,000	2005-2006	800
21	Muhur	Dibër	200	1976	152,000	40,000	25,000	217,000	2003-2004	950
22	Rajan	Kolonjë	200	1974	152,000	40,000	25,000	217,000	2005-2006	750
23	Marjan	Korçë	200	1980	152,000	40,000	25,000	217,000	2005-2006	930
24	Lozhan	Korçë	150	1982	100,000	50,000	25,000	175,000	2002-2003	560
25	Treskë 2	Korçë	130		100,000	45,000	25,000	170,000	2007-2008	560
Total			8,490		5,965,680	1,845,000	825,000	8,636,000		38,210

ANEKS NR.2
LISTA E HIDROCENTRALEVE ME PROBLEME NGA PRONARËT E TRUALLIT

Nr.	Emri i HEC	Vendndodhja (rrethi)
1.	Tuçep	Bulqizë
2.	Martanesh	Bulqizë
3.	Lenie	Gramsh
4.	Vithkuq	Korçë
5.	Xhyrë	Librazhd
6.	Çorovodë	Skrapar

VENDIM
Nr. 469, datë 3.10.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 371 DATË 4.8.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE KOMPETENCAT NË FUSHËN E
STANDARDIZIMIT, CERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6 e kreut I të vendimit nr. 371, datë 4.8.1999 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, sipas kërkesave të subjekteve të interesuara, private dhe/ose shtetërore, organizon grup pune për kryerjen e ekspertizave për standardet.

Tarifat për shërbimet e mësipërme përcaktohen në mbështetje të pikës 12 të nenit 9 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 470, datë 3.10.2002

PËR KUSHTET E DHËNIES SË AUTORIZIMIT ZYRTAR DHE RREGULLAT E
NDËRMJETËSIMIT NË SIGURIME DHE RISIGURIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime është veprimtaria e ofrimit, negocimit, nënshkrimit dhe shitjes së kontratave të sigurimit.

Operacione sigurimi mund t’i paraqiten publikut nëpërmjet ndërmjetësve të sigurimit, si më poshtë vijon:

a) Agjentët janë persona, fizikë ose juridikë, të autorizuar nga siguruesi ose risiguruesi për të kryer operacione sigurimi dhe/ose risigurimi në emër të siguruesit ose të risiguruesit. Agjenti i sigurimit kryen operacione vetëm në emër të një siguruesi dhe/ose risiguruesi.

b) Komisionerët (brokerat) janë persona, fizikë ose juridikë, të autorizuar nga i siguruari për të kryer operacione sigurimi dhe/ose risigurimi për llogari të të siguruarit. Komisioneri (brokleri) përfaqëson të siguruarin në ofrimin, negociimin ose nënshkrimin e kontratave të sigurimit, si dhe mund të kryejë shërbimet e rastit për funksionet e mësipërme.

c) Punonjësit e shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit, të shoqërive të agjentëve të sigurimit apo të shoqërive të komisionit (brokerimit) janë persona fizikë, të emëruar për këtë qëllim, që propozojnë, paraqesin ose përgatisin kontrata sigurimi, në emër dhe nën përgjegjësinë e punëdhënësve të tyre, përkundrejt një page apo një shpërblimi të caktuar.

2. Agjentët dhe komisionerët (brokerat) u nënshtrohen detyrimit dhe kontrollit periodik të plotësisimit të aftësisë profesionale dhe të besueshmërisë.

2.1. Kontrolli i aftësisë profesionale bëhet në mënyrë periodike, çdo 3 vjet, nga një komision testimi pranë Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, për ndërmjetësit e pajisur me autorizim zyrtar.

2.2. Me vendim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve ngrihet komisioni i testimit profesional, i cili përcakton kohën (jo më shumë se dy herë në vit), dhe procedurat e vlerësimit të testimit të aplikantëve për pajisjen me autorizim zyrtar në ndërmjetësim.

2.3. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve pajis me autorizim zyrtar vetëm ata aplikantë që kanë përmbushur kriterin profesional dhe atë të besueshmërisë.

3. Kriteret e aftësisë profesionale të ndërmjetësve të sigurimit dhe/ose risigurimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, janë si më poshtë vijon:

- të jetë shtetas shqiptar mbi moshën 25 vjeç;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë kryer të paktën arsimin e mesëm;
- të ketë përvojë në fushën e sigurimeve, jo më pak se një vit kalendarik;
- të njohë legjislacionin shqiptar në fushën e sigurimeve;
- të ketë dokumentin e njohurive bazë në përdorimin e kompjuterit.

3.1. Komisioneri (brokleri), përveç kriterëve të mësipërme, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- të ketë mbaruar studimet universitare;

- të vërtetojë me dokument kryerjen e një kualifikimi komisionimi (brokerimi), jo më pak se 6 muaj nga enti kualifikues;

- të ketë përvojë pune, jo më pak se dy vjet, pranë një shoqërie sigurimi dhe/ose risigurimi, në pozicionin e drejtuesit të personelit profesional ose në autoritetet mbikëqyrëse të sistemit financiar.

3.2. Ndërmjetës sigurimi është çdo shtetas i huaj, i cili vërteton se zotëron një leje për ushtrim veprimtarie, sipas rregullave të shtetit të origjinës, si dhe plotëson kërkesat e pikave 3, 3.1 dhe 4 të këtij vendimi, me përjashtim të kushtit të shtetësisë shqiptare.

4. Kriteri i besueshmërisë, sipas pikës 2 të këtij vendimi, përmbushet kur vërtetohet se ndërmjetësi:

- me anë të një dëshmie penaliteti, nuk rezulton i dënuar;
- nuk rezulton debitor në organet tatimore dhe doganore;
- nuk rezulton debitor ndaj shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit që veprojnë në treg;
- nuk është i punësuar, aksioner apo i zgjedhur në organet drejtuese të një shoqërie sigurimesh dhe/ose risigurimesh;

- në rastin e komisionerit (brokerit) apo shoqërisë së komisionit (brokerimit) vërteton se ka një garanci financiare, sipas pikës 2.1 të këtij vendimi.

5. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është i vetmi autoritet zyrtar që autorizon kryerjen e veprimtarive në fushën e ndërmjetësimit në sigurime dhe/ose risigurime.

5.1. Nëse një kërkesë për dhënie autorizimi zyrtar për ushtrim veprimtarie ndërmjetësimi në sigurime dhe/ose risigurime është refuzuar me vendim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, aplikanti mund të ankohet, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në Gjykatën e Rrethit të Tiranës.

6. Kur kushtet e parashikuara në pikën 4 të këtij vendimi nuk përmbushen, me vendim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve tërhiqet autorizimi i dhënë nga ky komision.

6.1. Kundër vendimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve mund të bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës.

7. Agjenti përfiton nga siguresi dhe/ose risiguresi një shpërblim, të përcaktuar në kontratën e agjentit, të lidhur ndërmjet tij dhe siguresit.

7.1. Agjenti i sigurimeve propozon, paraqet, përgatit, nënshkruan dhe shet kontratat e sigurimeve, për llogari të siguresit dhe/ose risiguresit.

7.2. Agjenti nuk mund të autorizojë asnjë person tjetër, fizik apo juridik, të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij.

8. Agjenti i ofron të siguruarit ndihmën e nevojshme përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, si dhe në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

8.1. Të drejtat, detyrimet dhe autoriteti i agjentëve të sigurimeve janë të përcaktuara në kontratën e nënshkruar (kontrata e agjentit) ndërmjet agjentit dhe siguresit, të cilin agjenti përfaqëson.

8.2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kontrata e agjentit janë si më poshtë vijon:

- shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar nga agjenti i sigurimit në ushtrimin e funksionit të tij;

- shpërblimi që përfiton agjenti nga siguresi;

- adresa ku agjenti ushtron veprimtarinë e vet;

- produkti që siguresi autorizon agjentin të tregtojë në emër dhe për llogari të tij;

- afati, e drejta dhe detyrimet e palëve kontraktuese;

- sanksionet;

- rastet e zgjidhjes së kontratës.

9. Kontrata e agjentit i vihet në dispozicion përfaqësuesit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, gjatë kontrollit në vend, si në shoqërinë e sigurimeve, ashtu edhe në objektin ku agjenti ushtron veprimtarinë.

10. Siguruesi njofton, me shkrim, brenda 10 ditëve, Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, për çdo ndryshim apo zgjidhje të kontratës me agjentët e vet, duke arsyetuar dhe shkaqet e ndryshimit.

11. Vlefshmëria juridike e autorizimit zyrtar nis pasi Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve pajis të autorizuarin me leje për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit. Kjo leje është pjesë përbërëse e autorizimit zyrtar.

11.1. Leja për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit i lëshohet të autorizuarit vetëm pas paraqitjes dhe miratimit në Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të kontratës së lidhur të agjentit me një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi, të autorizuar nga ky komision.

11.2. Personat e pajisur me autorizim zyrtar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit të sigurimeve paguajnë, për llogari të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, tarifën prej 50 000 lekësh.

11.3. Emrat e agjentëve të sigurimeve, të autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit, regjistrohen, sipas numrit rendor të autorizimit zyrtar, në regjistrin e agjentëve të sigurimeve, që mbahet nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

11.4. Forma e mbajtjes së regjistrit të agjentëve caktohet me rregullore të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

11.5. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është i detyruar të njoftojë, pas çdo testimi, listën e agjentëve dhe të komisionerëve (brokrerave) të autorizuar prej tij, në jo më pak se tri gazeta me qarkullim kombëtar.

12. Vlera për regjistrimin e shoqërive të agjentëve të sigurimeve është sa gjysma e shumës së përgjithshme që duhet të paguajnë të gjithë agjentët, anëtarë të shoqërisë, sikur të ishin persona fizikë më vete.

12.1. Leja për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit rinovohet çdo vit, pas rivlerësimit të kriterëve të besueshmërisë, nga komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe regjistrohet në një regjistër të veçantë që mban ky komision.

12.2. Rinovimi i lejes për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë shoqërohet me tarifën prej 20 000 lekësh, që paguan ndërmjetësi në favor të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

13. Autorizimi zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë nga agjentët hiqet kur:

- agjenti heq dorë vullnetarisht nga autorizimi zyrtar;
- ushtron veprimtari tjetër nga ajo e autorizuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka shkaktuar dëm financiar ndaj shoqërisë në emër dhe për llogari të së cilës punon;

- agjenti ka shkelur legjislacionin shqiptar në fushën e sigurimeve;
- agjenti është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
- agjenti në ushtrimin e veprimtarisë ka dëmtuar interesat e policëmbajtësit;
- provohet se dokumentet për pajisjen me autorizim zyrtar janë të falsifikuara.

13.1. Leja për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së agjentit hiqet kur:

- Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve i heq shoqërisë së sigurimit autorizimin zyrtar;
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve heq automatikisht edhe lejen për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së agjentit për të gjithë ata agjentë që veprojnë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie sigurimi;

- kontrata e agjentit zgjidhet.

14. Vendimi i Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve për heqjen e autorizimit zyrtar i bëhet i ditur agjentit dhe të gjitha shoqërive të sigurimeve, si dhe botohet në tri gazeta me qarkullim kombëtar, brenda pesë ditëve nga marrja e këtij vendimi.

14.1. Ankimi kundër vendimit për heqjen e autorizimit zyrtar, në rast të moszgjidhjes në Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, bëhet pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

15. Zgjidhja e siguruesit nga i siguruari është e lirë dhe siguruesi paguan një shpërblim të komisioneri (brokeri).

16. Komisioneri (brokeri), gjatë ushtrimit të funksionit, duhet të njoftojë të siguarin për versionet e mundshme të kontratës së sigurimit.

16.1. Komisioneri (brokeri), gjatë ushtrimit të funksionit, duhet të njoftojë të siguarin, përpara lidhjes së kontratës të sigurimit, për termat dhe kushtet e saj, veçanërisht për primin e sigurimit dhe kufizimet apo përjashtimet e kontratës së sigurimit.

16.2. Komisioneri (brokeri) duhet të kryejë procedurat parapërgatitore për nënshkrimin e kontratës së sigurimit.

16.3. Komisioneri (brokeri) duhet të njoftojë të siguarin për zhvillime të reja në fushën e sigurimeve.

17. Vlefshmëria juridike e autorizimit zyrtar, dhënë nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, për një komisioner (broker), nis në çastin e regjistrimit të tij në regjistrin e posaçëm që mban ky komision.

17.1. Emrat e komisionerëve (brokerave), të autorizuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, regjistrohen sipas numrit rendor të autorizimit zyrtar.

17.2. Forma e mbajtjes së regjistrit të komisionerëve (brokerave) caktohet me rregullore të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

17.3. Komisioneri (brokeri), për regjistrimin e vet, paguan tarifën prej 100 000 lekësh.

18. Shoqëria e komisionit (brokerimit) paguan një tarifë sa gjysma e shumës së përgjithshme që do të paguanin komisionerët (brokerat), anëtarë të shoqërisë, sikur të ishin persona fizikë më vete. Kjo paguhet çdo 3 vjet, sa herë që ripërtërihet autorizimi.

19. Komisionerëve (brokerave) apo shoqërive të komisionit (brokerimit) në sigurime, përveç rasteve të parashikuara në pikat 6 dhe 13 të këtij vendimi, iu hiqet autorizimi edhe në rastet e mëposhtme:

a) kur provohet se dokumentet e paraqitura për marrjen e autorizimit janë të falsifikuara;

b) kur nuk zotërojnë më garancinë financiare;

c) kur heqin dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë së komisionit (brokerimit) në sigurime.

20. Komisioneri (brokeri) duhet të zotërojë, në çdo kohë, një garanci financiare të barabartë me mesataren mujore të primeve të grumbulluara nga ai në 12 muajt e fundit, por kjo shumë nuk mund të jetë më e vogël se 40 milionë lekë për një komisioner (broker).

21. Garancia financiare është një shumë në cash, e bllokuar për llogari të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në një nga bankat e nivelit të dytë, ku ndodhet selia qendrore e saj. Kjo garanci mund të përfaqësohet edhe nga letrat me vlerë, të emetuara nga shteti, me afat maturimi jo më të vogël se një vit ose kontratë përgjegjësie (policë) e një shoqërie sigurimi, të autorizuar nga ky komision.

21.1. Garancia financiare lëshohet për llogari të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

22. Në proces likudimi, të siguarit gëzojnë të drejtën ndaj garancisë financiare.

23. Komisionerët (brokerat) i nënshtrohen parimit të sekretit profesional, përveçse para Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

24. Komisionerët (brokerat) duhet të raportojnë në Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në mënyrë periodike. Forma dhe mënyra e raportimit përcaktohen në rregulloren e këtij komisioni.

25. Funkzioni i komisionerit (brokerit) është i papajtueshëm me atë të agjentit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 113, datë 30.9.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “ALSAT 1”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO-ALSAT-1” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “Radio-Alsat-1” sh.p.k. me vendndodhje në Tiranë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr. 114, datë 30.9.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “FANTASY”
SUBJEKTIT: Z. SAIMIR BAGOSI

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Saimir Bagosi, me vendndodhje në Kavajë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr. 116, datë 30.9.2002

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “ROCK”
SUBJEKTIT: “RADIO ROCK” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Radio Rock” sh.p.k., me vendndodhje në Tiranë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
 2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor Bogovë-Çorovodë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë njëjavore dhe, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Monitorimit).

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e objektit: “Segmenti rrugor Tapizë-Fushë Krujë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë njëjavore dhe, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Monitorimit).

KËRKESE

Xhemal Xhelili, lindur dhe banues në Vlorë, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, shpalljen e vdekur të djalit Fatmir Xhelili.





KËRKUESI
Xhemal Xhelili

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodin Doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).



U dorëzua për shtyp më 7.10.2002

Doli nga shtypi më 8.10.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë